



BULETINI I PROKURORISË THEMELORE NË GJILAN

Janar – Mars 2024



Përmes këtij buletini do të pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Gjilan, për periudhën kohore Janar-Mars 2024.

Ndalohen tre persona për rrezikim të trafikut publik dhe mosdhënie të ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik

Gjilan, 26 Janar 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti Përgjithshëm, ka ndaluar të dyshuarit F.A. dhe B.A., në kohëzgjatje prej 48 orëve, për shkak të dyshimit se kanë kryer veprat penale “Rrezikimi i trafikut publik me veprime apo mjete të rrezikshme” dhe “Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik”, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe të dyshuarin L.M., për shkak të veprës penale “Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik”, të KPRK-së.

Ekziston dyshimi i arsyeshëm se të dyshuarit F.A. dhe B.A, më 25 Janar 2024, rreth orës 00:50 minuta, me automjetet e tyre, së bashku me tani të ndjerin L.R., gjatë drejtimit të automjeteve kanë zhvilluar gara, të cilat janë të ndaluara me ligj, që nga dalja e Gjilanit deri në hyrje të fshatit Dobërçan, ku edhe i ndjeri L.R., ka pësuar vetaksident dhe ka humbur jetën.

Po ashtu, dyshohet se pas vetaksidentit, të dyshuarit – vozitësit F.A. dhe B.A., si dhe i dyshuari - pasagjeri L.M., nuk i kanë dhënë ndihmë tani të ndjerit L.R., duke u larguar nga vendi i ngjarjes.

Prokurori i rastit, brenda afatit ligjor ndaj të dyshuarve do të kërkojë masën për sigurimin e të pandehurve në procedurë penale.

Ndalohet një person për fotografim dhe incizim të paautorizuar

Gjilan, 6 Shkurt 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti Përgjithshëm, ka kërkuar caktimin e masës së paraburgimit nga Gjykata Themelore në Gjilan ndaj të pandehurit L.B., për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale “Fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuara”, nga neni 202 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas kërkesës, ekziston dyshimi i bazuar se më 14 Janar 2024, në Gjilan, i pandehuri L.B., me dashje dhe pa autorizim ka cenuar privatësinë e të dëmtuarës, ashtu që fillimisht përmes numrit të tij të telefonit në aplikacionin “WhatsApp”, ka kanosur të dëmtuarën se nëse e njëjta nuk kryente veprime sipas dëshirës së tij, do t’ia publikonte fotografitë nudo, ku pasi që e njëjta nuk iu kishte bindur kërkesës së tij, i pandehuri i kishte shpërndarë fotografitë në rrjetin social “Telegram”.

I pandehuri me urdhër të prokurorit gjendet në ndalim 48 orësh, për shkak të veprës së sipërsëhënuar penale.

Aktakuzë ndaj katër personave për uzurpim të paligjshëm të pronës së paluajtshme dhe keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar

Gjilan, 7 Shkurt 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve G.P., M.Sh., V.I. dhe Gj.N., për shkak të veprave penale “Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme” dhe “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas aktakuzës i pandehuri G.P., që nga viti 2021, në mënyrë të kundërligjshme ka uzurpuar dy parcela kadastrale, njëra në sipërfaqe prej 14357 m² dhe tjetra në sipërfaqe prej 8859 m², pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Ereniku Prodhimtaria Primare" në Gjakovë, me të cilën administron Agjencia Kosovare e Privatizimit, ashtu që i pandehuri në vazhdimësi ka shfrytëzuar këto prona duke ndërtuar 3 objekte dhe duke vendosur një kontejner, pa ndonjë bazë të vlefshme juridike.

Me këto veprime, i pandehuri ka kryer veprën penale “Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme”, nga neni 320 paragrafi 1 të KPRK-së.

Ndërsa, tre të pandehurit e tjerë si persona zyrtar, të pandehurit V.I. dhe M.SH., në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për Komasaçion nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Komunën e Gjakovës, si dhe i pandehuri Gj.N., në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Komunën e Gjakovës, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror kanë keqpërdorur detyrën zyrtare, duke qenë në dijeni se parcelat e sipërshënuara janë pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Ereniku Prodhimtaria Primare" në Gjakovë, me të cilën administron Agjencia Kosovare e Privatizimit, ashtu që i pandehuri V.I., i ka mundësuar palës A.N., bartjen e pronës në emër të tij, duke u bazuar në kërkesën e tij verbale e në disa vendime të komasaçionit, ashtu që me Vërtetimin e datës 16.12.2021, të pa protokolluar, vërteton se A.N., nga Gjakova është pronar dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike, Drejtoria për Kadastër në Gjakovë e bartë parcelën e lartcekur fillimisht në emër të A.N., e më pas me Kontratë të shitblerjes në mes të palës A.N. dhe të pandehurit G.P., prona ka kaluar në emër të pandehurit, pa pëlqim dhe njoftim të AKP-së si administruese e vetme e pronës shoqërore.

I pandehuri M.SH., i ka mundësuar palës A.N., bartjen e pronës në emër të tij, duke nxjerrë aktvendim, si dhe duke përpiluar dhe nënshkruar kopjen e planit për parcelën, ndërsa, i pandehuri Gj.N., i ka mundësuar të pandehurit G.P. bartjen e pronës në emër të tij, duke nxjerrë aktvendim me të cilin të njëjtit i aprovet kërkesa për bartjen në pronësi të parcelave.

Me këto veprime, të pandehurit M.Sh., V.I. dhe Gj.N., secili veç e veç kanë kryer veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK-së.

Administratori Rukovci nga Prokuroria Themelore në Gjilan priti në takim monitoruesin Lewocki nga EULEX-i

Gjilan, 21 Shkurt 2024

Administratori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, z. Hasan Rukovci, ka pritur në takim monitoruesin nga Eulex-i, z. Grzegorz Lewocki, ku pjesë e këtij takimi ishte edhe trajneri për rajonin e Gjilanit, nga projekti në kuadër të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), z. Shkëlqim Dushica.

Fillimisht nga Administratori Rukovci u prezantuan raportet e punës së Prokurorisë Themelore në Gjilan për vitin 2023, ku theksoi se të gjitha veprimet përpos në mënyrë manuale zbatohen edhe përmes programit SMIL, si nga prokurorët ashtu edhe nga stafi administrativ.

Gjithashtu u diskutua edhe sa i përket raporteve me kryerës të njohur dhe të panjohur të veprave penale dhe ndërlidhja e lëndëve dhe parashtrësive, të cilat barten në gjykatë.

Monitoruesi nga EULEX-i Lewocki në fund të takimit e falënderoi Administratorin Rukovci për pritjen dhe pasqyrimin e raporteve të punës përmes programit SMIL.



Kryeprokurori Kadriu priti në takim Mbikëqyrësin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndhmë Viktimave të Krimin në Gjilan

Gjilan, 28 Shkurt 2024

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, z. Arben Kadriu ka pritur në takim Mbikëqyrësin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndhmë Viktimave të Krimin, në Gjilan, z. Gani Leci.

Pjesë e këtij takimi ishte edhe prokurorja nga Departamenti Përgjithshëm i kësaj prokurorie, njëherit edhe koordinatore për veprat penale të dhunës në familje.

Qëllimi i këtij takimi ishte koordinimi i obligimeve gjatë mbrojtjes së viktimave të krimit, të cilët premtuan rritje të bashkëpunimit dhe angazhimit edhe më të madh në ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, duke iu ofruar trajtim sa më adekuat, në mënyrë që të mos riviktimizohen.

Gjithashtu nga Mbikëqyrësi i ZMNV-së u paraqitën edhe sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë realizimit të obligimeve të tyre ligjore pasi regjioni i Gjilanit mbulohet vetëm nga tre zyrtarë për mbrojtjen e viktimave të krimit.



Kryeprokurori dhe Administratori i Prokurorisë Themelore në Gjilan pritën në takim Drejtorin e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës

Gjilan, 28 Shkurt 2024

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, z. Arben Kadriu dhe Administratori i kësaj prokurorie z. Hasan Rukovci kanë pritur në takim Drejtorin e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Sami Istrefi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij.

Fillimisht Kryeprokurori Kadriu dhe Administratori Rukovci kanë falënderuar Drejtorin Istrefi për këtë vizitë, duke e vlerësuar gatishmërinë drejt nevojave konkrete të Prokurorisë Themelore në Gjilan, me ç'rast u pasqyruan edhe raportet e punës për vitin 2023 nga kjo prokurori.

Në pjesën e dytë të takimit, morën pjesë edhe gjithë stafi administrativ i Prokurorisë Themelore në Gjilan, të cilët patën mundësinë që të shprehin të gjitha sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë përbushjes së detyrave të tyre.

Në fund të takimit të njëjtit u pajtuan që takime të tilla të realizohen edhe në vijim me qëllim të koordinimit të plotë të aktiviteteve të përbashkëta.





NJOFTIM PËR MEDIA

Gjilan, 28 Shkurt 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, ju njofton rreth personit të raportuar më 09 Janar 2024 si person i humbur, i cili është gjetur pa shenja jete më 26 Shkurt 2024.

Në datën e lartcekur, rreth orës 22:45 minuta, nën ashensorin e një objekti banesor në Gjilan është gjetur pa shenja jete tani i ndjeri M.H. (1958), në të cilin objekti i njëjti ka banuar.

Pas raportimit si person i humbur, dyshimet e para kanë qenë në drejtim të veprës penale ‘‘Rrëmbimi’’, pasi i njëjti pas lirimimit nga qendra e paraburgimit në Lipjan, më 09 Janar 2024, kishte pasur me vete 86,250 Franga zvicerane, prandaj Prokuroria Themelore në Gjilan, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve në drejtim të kësaj vepre penale dhe veprime të shumta hetimore.

Pas gjetjes së personit të zhdukur, në çantën e tij është gjetur edhe shuma e lartcekur e të hollave prej 86,250 Franga zvicerane, si dhe 350 Euro, tre telefona mobil dhe sende tjera personale.

Prokurori i shtetit ka dhënë urdhër që trupi i pa jetë i të ndjerit të dërgohet për autopsi në Institutin e Mjekësisë Ligjore. Po ashtu janë angazhuar ekspertë nga fakulteti teknik, me qëllim të ekspertimit të funksionalitetit teknik të ashensorit, janë bërë urdhëresat për ekzaminimin e telefonave dhe janë ndërmarrë veprime tjera hetimore.

Lidhur me veprimet e tjera të mëtutjeshme do të jeni të njoftuar me kohë.

Ndalohejt një person për mashtrim dhe vjedhje të identitetit

Gjilan, 29 Shkurt 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti Përgjithshëm, ka ndaluar të dyshuarin A.S., në kohëzgjatje prej 48 orëve, për shkak të dyshimit se ka kryer veprat penale ‘‘Mashtrimi’’ dhe ‘‘Vjedhja e identitetit dhe kredencialeve’’ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Dyshohet se i njëjti duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë dhe varësinë nga substancat narkotike të një personi ia merr kartelën bankare dhe më pas në rrjetet sociale bënë thirrje për ndihmë në shumë prej 160.000.00 euro, kinse për shërim të djalit të të dëmtuarit G.D., i cili realisht nuk ekziston, ashtu që 30 persona dërgojnë para për ndihmë dhe i dyshuari tërheq një shumë rreth 4,296.50 euro.

Prokuroria Themelore në Gjilan brenda afatit ligjor ndaj të njëjtit do të kërkojë masën për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale.

Aktakuzë kundër tre personave për marrje dhe dhënie të ryshfetit

Gjilan, 05 Mars 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit M.B., për shkak të veprës penale ‘‘Marrja e ryshfetit’’ dhe të pandehurve Sh.P. dhe N.O., për veprën penale ‘‘Dhënia e ryshfetit’’ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas aktakuzës, i pandehuri M.B., në mes të muajve prill dhe korrik të vitit 2023, në Prizren, në cilësi të prokurorit të shtetit të Prokurorisë Themelore në Prizren, pranon ofertën ose premtimin për dhuratë, në shumë prej 20.000 €, në atë mënyrë që gjatë përfaqësimit në Gjykatën Themelore në Prizren, më 31.03.2023, në këmbim të premtimit heq dorë nga ndjekja penale në mungesë të provave ndaj të akuzuarve: N.O., U.S. dhe A.S., për shkak të veprës penale ‘‘Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge’’, të KPRK-së.

Me këto veprime ka kryer veprën penale ‘‘Marrja e ryshfetit’’ nga neni 421 paragrafi 1 të KPRK-së.

Ndërsa, të pandehurit Sh.P. dhe N.O., me dashje dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë premtuar dhënien e ryshfetit për personin tjetër – tani të pandehurin M.B., me qëllim që i njëjti, në cilësinë e prokurorit të shtetit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor te datës 31.03.2023, të heq dorë nga aktakuza kundër të akuzuarve N.O., U.S. dhe A.S., për shkak të veprës të sipërhënuar penale.

Me këto veprime kanë kryer veprën penale ‘‘Dhënia e ryshfetit’’ nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

SQARIM PËR MEDIA

Gjilan, 06 mars 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, njofton opinionin publik se gjatë ditës së sotme portali “Nacionale” ka publikuar një intervistë me të pandehurin B.L. kundër të cilit Policia e Kosovës, më datë 14 Shkurt 2024 ka parashtruar kallëzim penal për shkak të veprës penale “Vjedhja e rëndë”, nga neni 315 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Ndaj të njëjtit me aktvendim për zgjerimin e hetimeve të datës 16 Shkurt 2024, kanë filluar hetimet për shkak të veprës penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 315 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2.1 dhe nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

I pandehuri B.L., ka qenë i pa arritshëm nga Policia e Kosovës dhe përkundër përpjekjeve të vazhdueshme të prokurorisë dhe policisë i njëjti ende nuk është arrestuar dhe gjendet në kërkim policor.

Për hir të korrektësisë ju informojmë se pretendimet e të akuzuarit në këtë intervistë nuk qëndrojnë, pasi ndaj të njëjtit prokuroria ka ngritur këto aktakuza:

- Më datë 01 tetor 2009 është ushtruar propozim akuzë për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” nga neni 332 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 23 të KPRK-së,
- Më datë 03 Mars 2010 është ushtruar propozim akuzë për veprën penale “Lëndimi i lehtë trupor” nga neni 153 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 4 të KPRK-së,
- Më datë 10 Janar 2011 është ushtruar propozim akuzë për veprën penale “Lëndimi i lehtë trupor” nga neni 153 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 4 të KPRK-së.

Aktakuzë kundër 6 personave për grabitje, armëmbajtje pa leje, shitblerje të armëve dhe përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm

Gjilan, 14 mars 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve D.G., M.L., K.Xh., A.B., V.S. dhe N.M., për shkak të veprave penale “Grabitja”, “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, me 18 Nëntor 2021, në rrugën regjionale Gjilan-Prishtinë, në fshatin Parallovë, komuna e Novobërdës, të pandehurit D.G., M.L., K.Xh., A.B., V.S. dhe N.M., në bashkëveprim, me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, kanë grabitur shumën e parave prej 996,271.24€ dhe 46,780.00 dollar amerikan (USD) në dëm të të dëmtuarve Bankës Pro Credit, me seli në Prishtinë dhe kompanisë “Besa Security”, me seli në Prishtinë, në atë mënyrë që i pandehuri D.G., ka siguruar dhe vënë në qarkullim automjetin e tipit “Volvo”, ndërsa i pandehuri M.L., si menaxher në Kompaninë “Besa Security”, ka përgatit automjetin special për transportimin e parave të gatshme, ashtu që i njëjti pa dijeni të pronarit të kompanisë, këtë automjet e ka dërguar në autoservis pronar i të cilës është i pandehuri K.Xh., ku aty bashkë me të pandehurin K.Xh., ia vendosin pajisjen elektronike për ç’aktivizim të motorit nga distanca përmes teledirigjimit dhe në ditën kritike të pandehurit A.B., V.S. dhe N.M., automjetin “Volvo” e fshehin në fshatin Parallovë, ndërsa me automjet “Zafira” i vihen pas në përcjellje automjetit “Fiat”, i cili kishte grumbulluar paratë nga automatet bankare për t’i dërguar në Bankën Qendrore Pro Credit në Prishtinë, ku me të arritur në fshatin Parallovë, e ndalin me teledirigjim dhe të njëjtit të maskuar dhe të armatosur me armë të gjata, fillimisht gjuajnë me armë, pastaj shoferin dhe tre punëtorë tjerë i nxjerrin jashtë, marrin nga automjeti 10 çanta të mbushura me para, i vendosin në automjetin e tyre dhe shkojnë tek vendi ku e kishin lënë automjetin “Volvo”, ndërsa automjetin “Zafira” e djegin.

Me këto veprime, të njëjtit në bashkëveprim kanë kryer veprën penale “Grabitja” nga neni 317 paragrafi 3 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Të pandehurit V.S., A.B. dhe N.M., akuzohen edhe për veprën penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, nga neni 367 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.


Po ashtu, i pandehuri A.B., akuzohet edhe për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së, ndërsa, i pandehuri V.S. edhe për veprën penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”, nga neni 364 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 77 të KPRK-së.

Të dhënat e përgjithshme statistikore sipas llojit të kallëzimit penal

Janar - Mars 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan ka pranuar gjithsejtë 996 lëndë (nga regjistri PP, PPN, PPP dhe NJN), ndërsa ka zgjidhur 724 lëndë të të gjitha natyrave, në një efikasitet të përgjithshëm të trajtimit të rasteve prej **79,74 %**.

Përmes grafikoni të mëposhtëm, pasqyrohen të dhënat e përgjithshme sipas llojit të kallëzimit penal/llojit të regjistrit.



Grafikoni 1: Paraqet të dhënat e përgjithshme statistikore sipas llojit të kallëzimit penal për periudhën Janar-Mars 2024